

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për përdoruesin

BUTAMOL

Shurup - 2 mg / 5 ml
(Salbutamol sulfat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Butamol dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Butamol
- Si ta merrni Butamol
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Butamol
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË BUTAMOL DHE PËRSE PËRDORET?

Shurupi Butamol përmban lëndën vepruese salbutamol sulfat. Salbutamoli është një simpatomimetik me veprim të drejtpërdrejtë, kryesisht me veti beta-adrenergjike dhe ka veprim selektiv mbi receptorët beta-2 (agonist). Sulfati i salbutamolit përdoret:

- si bronkodilatator në obstruksionet e kthyeshme të rrugëve të ajrit;
- për mjekimin dhe profilaksinë e astmës bronkiale;
- për mjekimin e sëmundjeve të tjera, si bronkiti dhe emfizema, të shoqëruara me obstruksion të prapësueshëm të rrugëve të frymëmarrjes.

Mjeku juaj mund t'ju ketë dhënë Butamol për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI BUTAMOL

Mos merrni Butamol në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj salbutamol sulfatit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të shurupit;
- jeni duke përdorur beta – blokues jopërzgjedhës si p.sh propranolol.

Tregoni kujdes të veçantë me Butamol

Salbutamoli duhet përdorur me kujdes në të sëmuret që vuajnë nga: tireotoksikoza (hipertiroidizmi), insuficienca e miokardit, risku për zgjatje të intervalit QT, aritmitë dhe hipertensionin.

Në të sëmuret diabetikë mund të shfaqet ketoacidozë, prandaj duhet ndjekur niveli i glukozës në gjak gjatë përdorimit të salbutamolit.

Duhet të tregohet kujdes gjatë bashkëadministrimit të salbutamolit me teofilinën, ose kortikosteroidët në rastin e trajtimit të astmës së rëndë sepse kushtet e pacientit mund të përkeqësohen dhe mund të shfaqet hipokalemia.

Duhet të tregohet kujdes gjatë bashkëadministrimit të salbutamolit me diuretikët sepse mund të shkaktohet hipokalemia.

Duhet të diskutoni trajtimin tuaj me mjekun ose farmacistin nëse keni problemet e mësipërme.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Butamol.

Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Butamol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit. Butamol nuk këshillohet të përdoret i përzier me preparate të tjera në formë lëngjesh.

Salbutamoli dhe beta-blokuesit jopërzgjedhës si propranololi zakonisht nuk duhet të përdoren së bashku.

Salbutamoli nuk duhet të merret njëkohësisht me teofilinën, diuretikët dhe me kortikosteroidët sepse rritet rreziku për hipokalemia.

Këshillohet të bëhet kontrolli i vazhdueshëm i përqendrimit të kaliumit në gjak në pacientët të cilët vuajnë nga asma e rëndë dhe mund të mjekohen me kombinime terapist të sipërpërmendura.

Marrja e Butamol me ushqim dhe pije

Nuk ka të dhëna.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji

Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut tuaj përpara se të merrni këtë bar.

Përdorimi i salbutamolit gjatë periudhës së shtatzënisë ose të ushqimit me gji duhet bërë vetëm në rast të domosdoshme dhe vetëm pasi të jenë vlerësuar përfitimet terapeutike për nënën me rrishten e mundshëm për fetusin apo fëmijën.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna që ky preparat mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin ose përdorur makineritë.

Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Butamol

Butamol shurup përmban:

- sukrozë - nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar;
- metilhidroksibenzoat (nipaginë) - mund të shkaktojë reaksione alergjike (ndoshta të vonuara).

3. SI TA MERRNI BUTAMOL

Gjithmonë merreni Butamol sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Butamol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Të rriturit, doza e zakonshme e efektshme është 4 mg (ose 10 ml shurup), 3 - 4 herë në ditë.

Në qoftë se nuk arrihet zgjerimi i mjaftueshëm i bronkeve, doza e njëhershme mund të rritet deri në 8 mg.

Në të sëmuret e mushuar ose në ata që dihet se kanë ndjeshmëri të theksuar ndaj nxitësve beta 2- adrenergjikë, këshillohet që mjekimi të fillohet me 2 mg, 3 ose 4 herë në ditë.

Fëmijët:

2 - 6 vjeç: 1 - 2 mg (2.5 ml - 5 ml), 3 - 4 herë në ditë

6 - 12 vjeç: 2 mg (5 ml), 3 - 4 herë në ditë

Mbi 12 vjeç: 2 - 4 mg (5 ml - 10 ml), 3 - 4 herë në ditë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Butamol

Në qoftë se keni marrë më shumë Butamol se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin më të afërt, ose të telefononi urgjencën

për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se harroni të merrni Butamol

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë dozë), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishitë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFekte ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Butamol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.

Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson.

Efektet anësore janë si më poshtë:

dridhje e lehtë e muskujve skeletikë, kryesisht e duarve, tension nervor, zgjerim i enëve periferike të gjakut, krampe muskulare, dhimbje koke, takikardi, hipokalemia pas dozave të larta, palpitacione, iskemi e miokardit, çrregullime të gjumit dhe shjelljes.

Janë konstatuar reaksione mbindjeshmërie me simptoma si:

bronkospazma paradoksale, urtikarie dhe angioedemë, hipotension, kolaps.

Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI BUTAMOL

Mbajeni larg fëmijëve.

Mos e përdorni Butamol pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.

Ruajeni në temperaturën midis 10°C - 25°C.

Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Butamol - Shurup 2 mg / 5 ml

Lënda vepruese është Salbutamol sulfat.

5 ml shurup përmbajnë salbutamol sulfat ekuivalent me 2 mg salbutamol.

Përbërësit e tjerë janë: acid citrik monohidrat, citrat natriumi, sukrozë, metil p-hidroksibenzoat (nipaginë), esencë limoni, ujë i pastruar.

Përmbajtja e paketimit

Kuti kartoni me një shishe të errët qelqi 150 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:



Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.



Përmbajtja.



Kujdes.



Shurup.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:



PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Mars 2016.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATTENTION, all the layers are visible.

If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.